REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 17 dhe nenit 18 paragrafi 18.1 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 9,17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, duke u bazuar në shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.020-513/5 datë 17.06.2021 dhe në shkresën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.22112/21 datë 15.06.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR ANULIMIN E VENDIMIT 15NR.30-30026 PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMËRIVE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË SEGMENTEVE RRUGORE "AFRIM ZHITIA", "MBRETI ZOG" DHE "KONGRESI I BLINAJËS" NË LIPJAN

Neni 1

1.ANULOHET Vendimi 15Nr.30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore "Afrim Zhitia", "Mbreti Zog" dhe "Kongresi i Blinajës" në Lipjan, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 03.06.2021.

2.OBLIGOHET Kryetari i Komunës të vazhdojë procedurat e shpronësimit konform nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:Nr.91/10 Dhjetor 2010.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 15-353-35804

Lipjan, më 30.06. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

